



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "TSR" Sh.P.K. të datës 23.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 20.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "TSR" Sh.P.K. e datës 23.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 20.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.
- II. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "TSR" Sh.P.K. se sipas vendimit të datës 03.04.2023 për shkak të kërkesës për rishqyrtim të një operatori tjetër ekonomik, autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës është autorizuar që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit të cituar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "TSR" Sh.P.K. dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "TSR" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 23.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 20.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim.

1. **Pretendimi i parë:** *“Autoriteti kontraktues shkel te 3 paragrafet e nenit 1 te ligjit per prokurim publik... duke e shpallur fitues nje operator ekonomik me oferte te papergjegjshme si dhe nje operator i cili ka ofertuar me nje qmim abnormalisht te ult gjithnje duke ju referuar LPP”.*
2. **Pretendimi i dytë:** *“...AK ka bere shkelje te ketij neni ne pergjithesi (neni 6 i LPP) ngase ka shpallur fitues nje operator ekonomik i cili ka dorzuar nje oferte te papergjegjshme...”.*
3. **Pretendimi i tretë:** *“...Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij paragrafi dhe te nenit 7 te LPP se ne pergjithesi lind pyetja se si eshte e mundur qe AK te mos vendos paramasen edhe pse asht kontrat korniz...andaj mos vendosja e paramases jep hapsir dhe dyshime te bazuara te manipulimit nga OE...”.*
4. **Pretendimi i katërt:** *“...ne njoftimin per eliminim thuhet se ne si OE si arsy jep se kinse ne se posedojm Botopalin qka sesht e vertet... ne qoft se do te ishte ber kerkesa siq duhet qe mjetet e koncercjunit do te ishte dashur qe te lajmrohemi me para dhe jo dite e premtje qe afati i inspektimit do jet te henen”.*
5. **Pretendimi i pestë:** *“Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te nenit 59 duke mos bere vleresimin e sakt te ofertes se operatorit ekonomik fitues. Siq shifet nga oferta e dorezuar nga operatori ekonomik ne paramasen e dorezuar operatori ekonomik ka dorezuar oferten me qmim abnormalisht te ulet. Pastaj gjat ekzaminimit te tendereve kta tender nuk eksaminohen sipas LPP pasiqe nuk ceken mangesit e OE tjer siq jan Psh ka OE qe si kan sjell fare modelet, pastaj ka OE tjer te cilet si kan fare dokumentacionin e nevojshme...”.*
6. **Pretendimi i gjashtë:** *“Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te nenit 69 duke mos bere vleresimin e sakt te ofertes se operatorit ekonomik te shpallur fitues nje OE me qmim abnormal te ulet...”.*
7. **Pretendimi i shtatë:** *“...OE i shpallur fitues sjell kinse nje kontrat qiraje te thjesht kinse e ka me firmen Visover nga Spanja per ket makineri ketu per qudi komisjoni i vlersimit beson ne pamjen e par ne ket deklarate... ne kete rast OE i shpallur fitues fare nuk i ka ne dokumentacionin dhe as ne listen e makinerive semaforet per sigurimin e punishtes e cila ka qen kerkes sipas aneksit 7...”.*
8. **Pretendimi i tetë:** *“neni 41 Rregullorja e prokurimit publik - Ak ka ber shkelje te ketij ligji i cili e sqaron se si duhet te veprohet ne qoft se ka fakte dhe dyshime se ka qmime abnormal te ulta dhe ne ket rast faktet jan te pakontestueshme...”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 54, 59, 61 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si “LPP”) si dhe nenin 41 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale si në vijim:

- njoftimi për kontratë i datës 12.10.2022;
- formulari B54 për korigjimin e njoftimit për kontratë i datës 25.10.2022;
- formulari B54 për korigjimin e njoftimit për kontratë i datës 03.11.2022;
- formulari B54 për korigjimin e njoftimit për kontratë i datës 14.11.2022;
- formulari B54 për korigjimin e njoftimit për kontratë i datës 22.11.2022;
- procesverbali i hapjes i datës 05.12.2022;
- oferta e operatorit ekonomik "Sinjal" Sh.P.K së bashku me mostrat e dorëzuara;
- oferta e operatorit ekonomik "TSR" Sh.P.K së bashku me mostrat e dorëzuara;
- raporti i komisionit për rivlerësim i datës 17.03.2023;
- njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 20.03.2023.

Duhet theksuar se parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur pretendimet e tij sipas kërkesës për rishqyrtim.

Pas njoftimit të datës 27.03.2023 për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 03.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij. Nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohet asnjë nga pretendimet e parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafi 62.1. nën paragrafi d) të RRPP sipas elaborimeve në vijim.

**Lidhur me pretendimin e parë dhe të dytë:** fillimisht duhet theksuar se në kuptim të nenin 60 paragrafit 60.2 dhe 60.3. të RRPP, parashtruesi mban përgjegjësinë për formulimin e pretendimeve të tij në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme në gjuhën që është parashtruar kërkesa për rishqyrtim. Në pretendimin e parë dhe të dytë parashtruesi konstaton se është shkelur neni 3 përkatësisht neni 6 i LPP pasi që është shpallur si tenderues i suksesshëm një operator ekonomik për të cilin parashtruesi pretendon se është i papërgjegjshëm. Megjithatë parashtruesi nuk arrin të specifikoj një ndërlidhje të tillë kauzale ndërmjet shkeljeve të pretenduara të nenit 3 dhe 6 të LPP si dhe arsyeve përse paska ardhur deri te këto shkelje. Parashtruesi përmes pretendimit të parë dhe të dytë aludon në disa shkelje që sipas tij kanë ndodhur sikurse është konstatuar përmes pretendimeve katër deri tetë. Në këtë mënyrë parashtruesi ka përsëritur në mënyrë të vazhdueshme konstatimin e tij të njëjtë duke e prezantuar si disa pretendime të ndryshme. Si shembull pretendimi për çmimin jo-normalisht të ulët është përmendur në pesë pretendime gjithsej dhe atë pretendimin e parë, pretendimin e dytë, pretendimin e pestë, pretendimin e gjashtë si dhe në pretendimin e tetë. Në fakt ky do të duhej të ishte prezantuar si një pretendim i vetëm. Përtej përsëritjes së panevojshme kjo ka bërë që pretendimet e parashtruesit të jenë të pakjarta dhe vështirë të kuptueshme si në aspektin juridik ashtu edhe në aspektin gjuhësor.

Sidoqoftë, sa i përket pretendimit të parë dhe të dytë parashtruesi nuk ka arritur të paraqes argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Në fakt nuk ka arritur as që të specifikoj pretendimet e tij por vetëm ka bërë aludime të përgjithshme se janë shkelur dispozita të caktuara të LPP sepse është rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik që është dashur të shpallet si i papërgjegjshëm. Mirëpo nuk ka arritur as përafërsisht që të tregoj përse është dashur të veprohet në këtë mënyrë dhe aq më pak të shpjegoj përse këto veprime apo mosveprime duhet të interpretohen si shkelje të dispozitave përkatëse të LPP. Prandaj nga provat materiale e administruara lidhur me pretendimin e parë dhe të dytë të parashtruesit është gjetur se këto dy pretendime janë të pabazuara në kuptim të nenit 62 par. 62.1. nënparagrafit d) të RRPP.

**Lidhur me pretendimin e tretë:** parashtruesi konstaton se është shkelur neni 7 i LPP duke aluduar në faktin se nuk janë përcaktuar sasi të indikative të kontratës kornizë të prokurimit publik. Një pretendim i tillë ka mundur të parashtrohet edhe me një kërkesë për rishqyrtim përmes të cilës do të kundërshtohet njoftimi për kontratë. Megjithatë parashtruesi në atë kohë nuk ka paraqitur këtë pretendim. Sidoqoftë, pas analizimit të njoftimit për kontratë, dosjes së tenderit (DT) dhe Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT) është gjetur se procedura e prokurimit që është duke u zhvilluar lidhur me këtë aktivitet është në përputhje të plotë me LPP dhe me RRPP. Përndryshe parashtruesi nuk ka arritur të paraqes argumente të qëndrueshme apo prova materiale me të cilën do të mund të vërtetohej e kundërta. Pjesa e pretendimit ku thuhet *“andaj mos vendosja e paramases jep hapsir dhe dyshime te bazuara te manipulimit nga OE”* konfirmon se edhe parashtruesi ka mbetur në nivel të dyshimit lidhur me këtë pretendim dhe nuk ka arritur që të konfirmoj këtë pretendim në mënyrë të pakontestueshme përtej çdo niveli të dyshimit të bazuar. Prandaj nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i tretë i parashtruesit është i pabazuar në kuptim të nenit 62 par. 62.1. nënparagrafit d) të RRPP.

**Lidhur me pretendimin e katërt:** përmes raportit të komisionit për rivlerësim të datës 17.03.2023 faqet 14 dhe 19 është gjetur se komisioni për rivlerësim ka dalë në teren për verifikimin e pajisjeve të tenderuesve nga data 13.03.2023. Ky fakt nuk kundërshtohet as nga parashtruesi. Përmes pretendimit të katërt parashtruesi pretendon se njoftimi i komisionit për dalje në terren nuk ka qenë si duhet sepse ka qenë afati shumë i shkurtër. Sipas komisionit për rivlerësim, njoftimi është bërë përmes emailit tri (3) ditë më herët përkatësisht me datë 10 mars 2023 për datën 13 mars 2023. Përndryshe parashtruesi asnjëherë nuk ka reagu ndaj këtij njoftimi për kërkuar afat shtesë apo sqarime shtesë nëse ka pasur diçka të pakuptueshme. Pakënaqësitë e tij janë shprehur vetëm përmes kërkesës për rishqyrtim për faktin se sipas raportit të komisionit në faqen 14 dhe 19 pas verifikimit të pajisjeve në terren është gjetur se te parashtruesi mungon pajisja Batipali për vendosjen e pahive elastike. Në këtë mënyrë rezulton se njoftimi dhe dalja e komisionit në terren është bërë në mënyrë plotësisht të rregullt. Njëkohësisht as parashtruesi nuk ka arritur të argumentoj përse njoftimi do duhej të ishte më i gjatë apo të ishte parashtruar ndryshe dhe se cila dispozitë juridike qenka shkelur në këtë rast nga komisioni. Prandaj nga raporti i komisionit rivlerësues i datës 17.03.2023 si provë materiale e administruar në këtë rast është gjetur se pretendimi i katërt i parashtruesit është i pabazuar në kuptim të nenit 62 par. 62.1. nënparagrafit d) të RRPP.

**Lidhur me pretendimin e pestë:** fillimisht duhet cekur se parashtruesi këtë pretendim e ka formuluar përmes dy (nën)pretendimeve, njëri prej të cilëve ka të bëjë me çmimin jo-normalisht të ultë ndërsa tjetri ka të bëjë se disa nga operatorët tjerë ekonomik (përtej tenderuesit të rekomanduar) nuk i kanë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara me DT. Sa i përket pjesës për çmimin jo-normalisht të ultë, kjo pjesë do të adresohet më poshtë lidhur me pretendimin e gjashtë dhe të tetë. Ndërsa sa i përket pjesës së pretendimit se disa nga operatorët tjerë ekonomik (përtej tenderuesit të rekomanduar) nuk i kanë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara me DT, fillimisht duhet cekur se për këtë kërkesë për rishqyrtim nuk është relevante se operatorët tjerë nuk i paskan plotësuar kriteret e DT. Kjo është edhe e nënkuptueshme përveç se jo-relevante pasi që sipas raportit të komisionit për rivlerësim tenderuesi i rekomanduar i ka plotësuar kriteret më mirë në raport me tenderuesit e tjerë. Sidoqoftë parashtruesi nuk ka arritur të shpjegojë se cila shkelje paska ndodhur për faktin që sipas tij operatorët tjerë (përtej tenderuesit të rekomanduar) nuk i kanë plotësuar kriteret e DT dhe ky fakt është ose jo i evidentuar në raportin e komisionit. Prandaj nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i pestë i parashtruesit është i pabazuar në kuptim të nenit 62 par. 62.1. nënparagrafit d) të RRPP.

**Lidhur me pretendimin e gjashtë dhe të tetë:** fillimisht duhet cekur se të dy këto pretendime kanë të bëjnë me çmimin jo-normalisht të ultë. Përmes nenit 41 paragrafit 41.1. të RRPP përcaktohet se *“Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës”*. Tutje përmes nenit 41 paragrafit 41.3. të RRPP përcaktohet se *“Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”*. Njëkohësisht përmes nenit 61 paragrafit 1 të LPP përcaktohet se *“Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni”*.

Nga raporti i komisionit për rivlerësim i datës 17.03.2023 rezulton se komisioni ka evidentuar se oferta e tenderuesit të rekomanduar në disa pozicione mund të jetë me çmime jo-normalisht të ulta. Për këtë arsye duke u bazuar në nenin 41 par. 41.3. të RRPP, me datë 13.03.2023 komisioni ka kërkuar nga tenderuesi i rekomanduar që të sqarojë se si do të arrijë që të përmbushë detyrimet e veta kontraktuese përmes çmimeve të ofertuara. Tenderuesi i rekomanduar ka ofruar sqarimet e tij të siç është kërkuar nga komisioni. Rrjedhimisht në raportin e komisionit është evidentuar se nga tenderuesi i rekomanduar është kërkuar të rritet siguria e ekzekutimit të kontratës nga 10% në 30%. Në këtë mënyrë komisioni ka vepruar në përputhje me dispozitat e RRPP dhe LPP të cituara më sipër. Këtë fakt parashtruesi nuk e ka potencuar fare në pretendimet e tij nr. 6 dhe nr. 8.

Rrjedhimisht parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument të qëndrueshëm për të vërtetuar pretendimet e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i gjashtë dhe i tetë i parashtruesit janë të pabazuara në kuptim të nenit 62 par. 62.1. nënparagrafit d) të RRPP.

**Lidhur me pretendimin e shtatë:** parashtruesi është shprehur se dokumentet që ka dorëzuar tenderuesi i rekomanduar përmes kompanisë “Visover” nga Spanja, nuk është dashur që t’iu falet besimi nga komisioni për rivlerësim. Mirëpo nuk ka treguar përse komisioni nuk është dashur që t’i falë besimin këtyre dokumenteve. Në këtë mënyrë parashtruesi nuk ka prezantuar argumente të qëndrueshme dhe për pasojë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimin e tij. Në pjesën tjetër të pretendimit parashtruesi shprehet se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar dëshmitë për “Semafor mobil për sigurimin e vend punishtes gjatë realizimit të sinjalizimit – 2 copë” - aneksi 7 në DT. Me këtë rast është gjetur se sipas Formularit B54 Standard për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara të datës 05.12.2022, nuk është kërkuar një dëshmi e tillë. Rrjedhimisht ky kriter nuk është evidentuar as në raportin e komisionit për rivlerësim. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se pretendimi i shtatë i parashtruesit është i pabazuar në kuptim të nenit 62 par. 62.1. nënparagrafit d) të RRPP.


Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Rrjedhimisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është gjetur se të gjitha pretendimet e parashtruesit janë pretendime të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Megjithatë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka pranuar edhe disa kërkesa tjera për rishqyrtim nga operatorët tjerë ekonomik që janë palë të interesuara. Me këtë rast është marrë vendimi i datës 03.04.2023 përmes të cilit është miratuar një nga këto kërkesa për rishqyrtim të një operatori tjetër ekonomik ashtu që është autorizuar autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës është autorizuar që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit të cituar në pikën I të këtij vendimi.

Për pikën I të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën II, III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 03.04.2023**

**Visar SHEHU**  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.